



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

EKSTRAKTI I PROCESVERBALIT

Të mbledhjes se pare te Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB) i mbajtur me datë 24.02.2023

Z. Alban Zogaj nënkyetar i Komunës se Prishtinës, e hapi mbledhjen e pare duke i përshëndetur të pranishmit, dhe i njoftojë me rendin e ditës.

Nën udhëheqjen e nënkyetarit Alban Zogaj, është mbajtur mbledhja e radhës e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi në Komunën e Prishtinës. Në këtë takim në të cilin morën pjesë përfaqësuesit komunal, përfaqësuesit e këshillave të bashkësisë, përfaqësuesit e komuniteteve, përfaqësuesit e grupeve fetare, përfaqësues nga Policia e Kosovës, etj.

Kryesuesi theksoi se është privilegji që merr pjesë në këtë takim. Ai pyeti të pranishmit nëse kanë për të shtuar ndonjë tematik, për ta vendosur si pikë e rëndit të ditës për tu diskutuar në këshill.

Njëzëri u miratua ky

Rend Dite

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Miratimi i Planit te veprimit Planit dinamik te punës;
3. Vlerësimi mbi çështjen e sigurisë ne Kryeqytet, informate nga policia e Kosovës;
4. Situata ne Komunë me ndriçim, parkingje, mbeturina dhe pastrimin e rrugëve;
5. Siguria ne shkolla, përdorimi i substancave narkotike dhe bartja e mjeteve te rrezikshme;
6. Situata me qenë endacak ne Komunën e Prishtinës;
7. Te ndryshme.

Njëzëri u miratua ky.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit te procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Njëzëri u miratua ekstrakti i mbledhjes se kaluar.

Pika e dytë

Miratimi i Planit te veprimit dhe lanit dinamik te punës.

Heten Kupina-e kam studiuar ne përpikëri, unë mendoj qe tani duhet miratohet e ne takimet e ardhme kur te komunikohet ndonjë rend ditës mund te shtojmë ndonjë pike tjetër.

Betim Abdullahu- kërkoi nga kryesuesi qe te hyj edhe ndonjë pike te caktuar për komitete për komunitete.

Alban Zogaj- ju falënderoj për pikën e shtë kërkësë e drejtë.

Njëzëri u miratua pika e dyte.

Pika e trete

Vlerësimi mbi çështjen e sigurisë ne Kryeqytet, informate nga policia e Kosovës

Melihate Sefedini stacioni policor veriu Prishtinë- ne përgjithësi gjendja e shtë e qete dhe meritat me te mëdha i kane banoret e zonës dhe puna e pamohueshme e zyrtareve policor ne terren.

Një përbledhje e shkurt e disa shifrave, gjate vitit 2022 krahasuar me vitin 2023 kemi pasur një ngritje te rasteve me 4.13%.

Rastet qe kane shënuar rritje kane qene rastet e grabitjeve me 71.42%, por fatmirësisht te gjitha këto raste janë zbuluar. Rritje kane shënuar edhe rastet e vjedhjeve, me se shumti janë shënuar ne rrjetet e marketeve VIVA, pak e shtë edhe moskujdesi e menaxhmentit te këtyre marketeve. Gjithashtu kane shënuar rritjet rastet e dhunës familjare 27.17%, rastet e posedimit te substancave narkotike 15.38% dhe rastet mbajtje posedim te armeve me 20.72%

Zbritje ne lëndime te lehta trupore me minus 17.59%, lëndim i rende trupore minus 41.17% rastet e dhunimeve minus 33.33%, rastet e vjedhjeve te renda minus 19.23%, asgjësim apo dëmtim i pasurisë minus 16.47%, zjarrvëns minus 31.25% gjithashtu aksidentet e trafikut me minus 4.23%.

Çështja e sigurisë dhe te numri i rasteve për muajin janar dhe shkurt te vitit 2023, ne muajin janar kemi pasur rritje te rasteve për rreth 9% krahasuar me vitin e kaluar ndërsa ne muajin shkurt kemi një rënie drastike te rasteve qe tani nëse e marrim krahasimin e vitit 2022 dhe 2023 janar-shkurt jemi me numër te njëjtë te rasteve.

Stacioni policor veriu dhe komplet Drejtoria Rajonale e Policisë Prishtinë, e shtë ne zbatim te një numri te madh te planeve operative. Isha ndal tek plani operativ transporti i nxënësve, këtë plan e kemi zbatuar për një javë gjate zbatimit te tij kemi vërejtur parregullsi te mëdha tek operatoret te cilët bartin nxënës për ne shkolle, kemi hasur ne automjete te transportit me vite te paregjistruar, pa patentë shofer, kombi bus pa ulëse fare, ku ka pasur deri ne 35 nxënës te futur brenda ne kombi bus jashtë çdo norme.

Gjate muajit shkurt kemi mbajtur ligjérata me temën parandalimi i ngacmimeve seksuale ne katër shkolla dhe kane qene pjesëmarrës 182 nxënës.

Po ashtu dy kërkesa i kemi për Komunën e Prishtinës:

Ne afërsi te stacionit policor veriu afër KFOR-it, eshë një pike ushqyese për qentë endacak, kisha kërkuar qe kjo pike te zhvendoset diku tjetër, sepse tani ne atë lokacion ka frekuentim te madh te qytetareve. Kërkesa e dyte pajisja me kontejner te rijnë, sepse kontejnerët aktual janë jashtë funksionit nga vjetërsia e tyre.

Major Vjollca Hoti komandant ne stacionin policor jugu - do te raportoj disa nga pikat e rëndësishme te raporti tone.

Falënderojmë Komunën e Prishtinës për bashkëpunimin qe e kemi pasur ne vitin 2022, po ashtu Qendrën për Puna Sociale Prishtinë, përkatësisht drejtorin Vehbi Mujku për bashkëpunimin qe e kemi pasur qe ka ndikuar ne ngritje te nivelit te sigurisë dhe ne aspektin social te qytetareve te zonës se përgjegjësisë.

Zona e përgjegjësisë stacioni policor jugu dallon nga rajonet tjera me një numër te larte te objekteve te rëndësishë se veçante, me ndërtim te hovshëm te objekteve te banimive, rritjes se zonës industriale, rritjes se numrit te qytetarëve dhe zone ku zhvillohetjeta e natës dhe me këto te dhëna kërkojnë aktivitetë shtesë. Gjate vitit 2022 kemi pasur rënie te numrit te rasteve për 7.7%, rënie te numrit te incidenteve për 19.9%, rënie vjedhje e rende 0.6%, vepra grabitje rënie 41.7%, lëndime te lehta trupore për 13.13.4%, veprat penale te armeve rënie 9.2%, ngritja e zbulushmerise se rasteve penale krahasuar me vitin p[paraprak kemi ngritje për 5.3 apo ne total për 55.8, ngritje te zbulushmerise se incidenteve 6.6 % me shume se vitin paraprak.

Shumica e shkollave te kryeqytetit gjenden ne këtë zone, fal punës dhe përkushtimit te zyrtarëve policor te cilët kane qene te angazhuar ne planin operativ siguria ne shkolla, kemi arritur qe gjate vitit 2022 te mos

me u shënuar asnjë incident i natyrës se rende. Ne këtë aspekt ka ndikuar direkt edhe Drejtoria për Arsim, përgjegjësit e shkollave si dhe prindërit. Duke pasur parasysh dhunën ne familje Kosova është një nder 7 vendet e botes qe ky projekt implementohet qe nga viti 2022 dhe vazhdon edhe këtë vit, fal mbështetjes nga KFOR-i, qe nga viti 2022 kemi edhe dhomën te cilën e shfrytëzojmë për rastet e dhunës ne familje dhe rastet me ndjeshmëri gjinore. KLSP lagja e Spitalit dhe lagja Mat ka realizuar projektin ne shkollën filllore "Pavarësia", ka rregulluar pjesën e parkingjeve për personelin e shkollës e cila ka ndikuar drejtpërdrejt tek siguria për nxënës.

Sfidat kane qene rritja e rasteve te dhunës ne familje dhe aktiviteteve policore qe ndërlidhen me këto raste 25.9% me shume se vitin e kaluar.

Sfide e cila na përcjellë edhe ne vitin 2023 është mos regjistrimi i qytetareve sipas vendbanimit kjo e vështirëson shume punën policore.

Numri i madh i ankesave për prishjen e rendit dhe qetësisë publike, uroj qe këtë vit te filloj implementimi i rregullores dhe kjo do te na e lehtësojë dukshëm punën tone.

Mosrespektimi i orarit te punës po ndikon direkt ne sigurinë e qytetareve tone, ku aty ndodhin edhe gjera te tjera, nëse komuna ndërmerr veprime konkrete ne këtë drejtim, kjo do te ngrit nivelin e sigurisë.

Synimi jone gjate vitit 2023 te kemi ulje te veprës vjedhje e rende për 2% si dhe veprës penale lëndim trupor për 2%, ngritura e bashkëpunimit me komunitetin me qellim te identifikimeve dhe zgjidhjen e problemeve. Tek te e ashtuquajtura "Lesna" shpresojmë te kemi bashkëpunim me komunën për vendosjen e kamerave, ndriçimit renovimi i saj, kjo do te ndikoj drejtpërsëdrejti ne sigurinë e qytetareve.

Zekeria Jonuzi toger shef i sek. Operatives Stacioni policor Qendra-stacioni policor qendra ka pasur një vit te suksesshëm, ku kemi bere prezantimin e raportit te punës. Mungese te kushteve tjera por edhe për shkak te angazhimeve te shumta te planeve operative, besoj qe ja kemi dale dhe e kemi mbajtur sigurinë ne nivel. Konsiderojmë se hapja e sheshit "George Bush", stacioni policor qendër ka hartuar dhe zbatuar planin operativ për festat e fund vitit, ku një falënderim i veçantë i shkon Komunës se Prishtinës të cilët na kane përkrahur ne këtë plan operativ.

Viti 2023 ne baze te raportit te punës edhe objektivave qe i kemi përcaktuar janë përafërsisht te njëjtë, me theks te veçantë do te jete shërbimi ndaj qytetarit pa dallim.

Çështja e shënimit te përvjetorit te 15-te te pavarësisë se Kosovës, siç e dini ne baze te agjendës qeveritare po ashtu edhe komunës se Prishtinës, ka qene një pjesëmarrje masive e qytetareve, ne kemi marr pjese diku rrëth 350 zyrtar policor ku gjithçka ka shkuar ne rregull.

Konsiderojmë qe situatën e sigurisë e kemi ne kontroll te plote dhe nuk ka ndonjë indikacion për rrezikim ose përkeqësim.

Sigurinë ne shkolla e kemi aset me vlerë, para jush e prezantoj zyrtarin policor Edmond Aliu i cili vazhdimisht është ne kontakt me DKA-ne, drejtoret e shkollave, prindërit, ku nuk kemi pothuajse incidente serioze asnjë.

Veprimet operacionale lidhur me lëmosh kërkuesit disa janë duke u depërtuar disave janë duke ju shqiptuar gjoba.

Sa i përket çështjeve te statistikave ne muajin janar kemi ulje te veprave penale ne 24%, dhuna ne familje nga 11 ne muajin janar këtë muaj i kemi 8 raste, veprat penale te narkotikeve kane rënie 9 raste, kemi ngritur te veprave penale komplekt 78 në 83, veprat penale kundër armeve kemi 24 me 17 te raportuara, aksidente te trafikut janë ne rënie nga 107 ne 83 kurse gjoba te shqipëruar është rritur nga 131 ne janar te vitit 2022 tanë kemi 183 gjoba dhe kemi një rënie te aksidenteve ne trafik, jemi te kënaqur me aktivitetet policore dhe me gjendjen e sigurisë.

Alban Zogaj- tanë po e hapim pjesën e diskutimit.

Violeta Hasani- një falënderim i veçantë shkon për komunën e Prishtinës për rëndësinë qe iu jep KLSP-ve. Artur Krasniqi- kam dy pyetje e para ka te beje me popullin qe kane ardhur nga luftërat si Siria etj. A ka një plan për këtë problematike, ata nuk kane mjet identifikimi dhe shpeshherë paraqesin kërcenim për sigurinë

ne qytet. Pyetja e dyte me adoleshentet pa kujdesin e prindërve, disa prej tyre me te meta psikikë, Qendra për Puna Sociale nuk merret shume me këto çështje, cofte marrja ne strehim ose marrja e te drejtës prindërore kështu qe mbesin ne rrugë, kish qene mire me gjete një plan dhe me u marr me këtë çështje. Zekeria Januzi- për çështjen e refugjateve qe e frekuentojnë territorin e republikës se Kosovës, tanë është numri me i vogël i tyre, Drejtoria për Migrim dhe te huaj i trajton këto raste, nuk mund ti quajmë qe janë ne situate rrugë sepse janë dy qendra ne komunën e Prishtinës.

Melihate Sefedini- tashme këta emigrant me rregulloren e re nga Ministria e Punëve te Brendshme qëndrojnë ne qendrat e pritjes për 15 dite dhe mbas kësaj obligohen qe ata ta lëshojnë territorin e republikës se Kosovës. Kufizimi lirisë se lëvizjes është vetëm pas orës 22:00 para kësaj janë te lire te dalin, sa i përket dokumenteve identifikuase nuk kane dokumente as nga vendet prej nga vijnë, mirëpo MPB ne bashkëpunim me Drejtorinë për Migrim dhe te Huaj, ju lëshon disa fleta qe është fotografia e personit emri dhe mbiemri gjithashtu dhe shteti prej nga vijnë.

Vjollca Hoti- te miturit lëmoshe kërkuesit ne rrugë te cilët paraqesin rrezik, policia e Kosovës ka plan te veçantë lidhur me këtë temë, jo rrallë here i marrim i dërgojmë para gjykatës ku është edhe keqpërdorimi i fëmijëve nga prindërit. Kemi njësi te veçantë e cila merret me trafikimin e qenieve njerëzore, i marrim i dërgojmë ne gjykate gjykata i dënon me mënyrat e saj, kështu qe problemi ne këtë rast nuk është tek policia dhe QPS-te, por tek vetëdijesimi i qytetareve, qytetaret duhet qe mos te vazhdojnë te japid lëmoshë.

Vebi Mujku drejtori i QPS-se, për ne është një shqetësim çështja e fëmijëve ne situate rrugë, ku shumica e tyre janë jashtë komunës se Prishtinës dhe nga shteti i Shqipërisë. E kemi formuar edhe një grup Kosove-Shqipëri për parandalimin dhe frekuentimin e këtyre fëmijëve. Sa i përket bashkëpunimit me policinë e kemi hapur një qendër ditore te cilën e finançon komuna e Prishtinës prej orës 8 deri ora 16, te gjithë përfituesit aty janë jashtë komunës se Prishtinës vetëm me qellim qe ta zbusim situatën. QPS-te nuk ka te drejte te ndërhyjnë tek fëmijët pa prezencën e policisë se Kosovës, marrja e te drejtës prindërore është veprim i cili merret prej gjykatës. Plani është duke shkuar ne vazhdimësi bashkëpunimi me policinë është dhe dimë qe e gjitha është tek problemi tek qytetaret kemi bere shume marketing dhe debate qe qytetaret te mos japid lëmoshë.

QPS-ja e ka një ndihme ne te holla njëherë ne muaj për rastet sociale, ku ndoshta edhe pa kriterë përfitojnë qe mos te thirren ne kushte ekonomike. Si QPS secilin rast e referojmë ne komunën përkatëse, po ashtu se bashku me policinë edhe e bëjmë transportin ne komunën përkatëse po ata prap kthehen këtu.

Qendrat ditore për te moshuar, aty shpërndahet edhe shujta ditore për te gjithë ata qe kane nevoje te ushqehen me kushte te renda përveç komunës se Prishtinës përmes kuzhinës qendrore, e kemi organizatën jetimët e Ballkanit e cila ju ofron po ashtu një sasi te shujtave.

Problem tjetër janë te pastrehët, por për këtë problem as komuna e Prishtinës as Kosova as Evropa nuk ka mundur me bere zgjidhje.

KLSP Dodona Safije Beseni te rintjtë qe po qëndrojnë rrugëve, ne pjesën ku jemi ne ka shume te rijnë te pa kontrolluar prej prindërve ku përdorin substanca narkotike janë diku rreth moshës 11 deri 14 vjeç, ne shkolla nuk i kontrollojnë dalin ne orar te shkollës dhe deri vone janë rrugëve. Nuk ka asnjë klub rinor apo aktivitet sportiv qe këta fëmijë mund te merren. Brenda parkut ndezin zjarr konsumojnë substanca dhe qytetarët rrezikohen prej tyre se ndonjëherë janë shume agresiv.

Pika e peste Siguria ne shkolla, përdorimi i substancave narkotike dhe bartja e mjeteve te rrezikshme Habib Qorri Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtje dhe Shpëtim- DSHP ne kuadër te aktiviteteve te veta për te gjitha këto qe u përmenden ndriçimi, mbeturinat, mirëmbajtjen e rrugëve, parkingu ju njoftoj qe nga viti i kaluar ne kemi pasur një vakum fillimisht te mirëmbajtja e ndriçimit publik dhe ndërkohë ne pjesën e dyte te vitit te kaluar janë nënshkruar kontratat diku janë 6 lloj, te cilat i përfshijnë rrugët e qytetit dhe rrugët rurale. Ne kohen sa ishte vakumi shume rrugë kane dale prej sistemit te mirëmbajtjes, mirëpo me nënshkrimin e kontravave jemi aktivizuar ne te gjitha rrugët ne mënyrë qe ndriçimi publik te kthehet ne funksion ne te gjitha rrugët. Projekti i cili është i planifikuar për çdo vit te behet zgjerimi i rrjetit te ndriçimit

publik dhe këto kontrata për shkak te procedurave te prokurimit kemi pasur vonesa, mirëpo tash edhe këto kontrata janë nënshkruar dhe jemi ne përgatitje te planit ne baze te kërkesave qe kemi pasur me qytetaret dhe takimeve me qytetaret te fillojmë zgjerimin e ndriçimit publik.

Sa i përket mirëmbajtjes se rrugëve janë aktivitete te cilat janë parapare ne kushte dimri dhe këtë vit nuk kemi pasur dimër me temperatURA te ulëta reshje bore dhe ngrica, tash jemi duke u përqendruar me tepër ne pastrimin e tyre gjate ditës, natën nuk kemi te drejte te i pastrojmë sepse paraqesim rrezik shkaku i temperaturat janë te ula.

Me mbeturina edhe ne si komune nuk jemi te kënaqur për shkak se janë duke u paraqitur probleme serioze tek kompania regjionale pastrimi për shkak te kapaciteteve, vjetërsisë se makinerive te tyre. Projektin vitin e kaluar e kemi iniciuar për kontejner te rijnë ende është ne procedure te ankesave, mirëpo edhe për këtë vit është duke u planifikuar një riorganizim i mbeturinave edhe me kompani private ne segmentet ku nuk mjaftojnë kapacitetet e kompanisë pastrimi.

Parkingjet publike është duke u zbatuar plani dhe rregullorja për menaxhim te parkingjeve publike, ne përgjithësi projekt i përfunduar duke u mirëpritur nga qytetaret.

Kemi filluar edhe ndryshimin e rregullores qe se shpejti shpresojmë qe do te prezantohet tek ju me te gjitha vërejtjet sugjerimet dhe mangësitë qe i ka pasur ne rregulloren e me hershme.

Mirsada Behluli përfaqësuese e komitetit te boshnjakeve si dhe kryesuese e komitetit për komunitete ne Komunën e Prishtinës- te gjithë përfaqësuesit e komuniteteve kane pasur ankesa për deponite e mbeturinave ne komune, rrugët te cilat i kane këto probleme janë:

Deponia ne rrugën "Xhem Shasivari", deponia ne rr. "Bajram Kelmendi", hedhja jolegale ne Bernice te Poshtme, ne Kalabri deponia e mbeturinave ne rr. "Sylejman Vuçitërna", afër Albi market, te kolektori ne Kalabri deponia e mbeturinave gjithmonë e stërmbrashur nga marketet VIVA fresh dhe Tregu i Gjelbër ku me shume hedhen dhe mbushen prej tyre se sa nga qytetaret.

Ne komitetin për komunitete njeri nga anëtarët ka paraqitur një problem qe ne shkollën "Xhevdet Doda" tavanet janë te prishura dhe kjo paraqet rrezik për nxënësit, për këtë është e lajmëruar drejtoresha e Drejtorisë. Problem tjetër janë trotinetet elektrik neper tretuar ku janë rrezik për qytetaret. Ne rr. "Caraleva", komuniteti ashkali i kane te nevojshëm policet e shtrire për shkak se ne atë rruge vozitin shume shpejt me vetura. Sa i përket çështjet se sigurisë te gjithë janë shprehur se te gjithë janë te sigurt dhe nuk kane probleme tjera.

Nënkyetari Alban Zogaj – kam një porosi nga kryetari Rama, është qe te fillojmë me menduar se bashku me policinë për lirimin e trotuareve se bashku me zhurmën dhe qentë endacak.

Andaj kryetari Rama ka kërkuar nga ne, një strategji se si mundemi me dale nga kjo situate, siç e keni vërejte ne kemi filluar me disa pengesa, por nuk mjaftojnë vetëm ato duhet te dalim edhe me aksione tjera për ti dënuar qytetaret te cilët bëjnë kundërvajtje ne parkim.

Zekeria Januzaj- ka shume pune për tu bere po tani është publike kemi pranuar një numër te madh te policeve te rijnë dhe çdo dite ne orën 8 e 30 mëngjes jemi duke raportuar ekskluzivisht për çështjen e lirimit te hapësirave për lëvizje te lire.

Artur Krasniqi- vazhdimisht ne komunën e Prishtinës ka ngarkime sidomos neper rruge, ajo qe na shqetëson shpesh here dëmtohen tabelat e rrugëve, emërtimet e tyre duam te dimë a ka ndonjë kontolle ndaj këtyre kompanive qe punojnë neper rruge te i kthejnë gjerat ne gjendjen e mëparshme. E dyta ne manifestime te ndryshme neper vendet tjera vendosen flamujt ne mënyrë te drejte neper qytete, tek ne janë te vendosura ne mënyrë jo te rregullte, nëse ka ndonjë zgjedhje kish qene mire me ndërhyrë dhe me i rregulluar.

Habib Qorri- kjo e flamujve vërejtje me shume te drejte, mirëpo ne kuadër te projektit për zgjerimin e ndriçimit e kemi parapare edhe ndërtimin e mbajtësve te flamurit.

Violeta Hasani- sa i përket Prishtina parking ne zonën tone ka eliminuar probleme te shumta jemi ne pajtim me ju përkrahë si komune me organizimin e banoreve qe Prishtina parking me hyre neper lagjet e Prishtinës.

Pika e gjashte Situata me qenë endacak ne Komunën e Prishtinës

Habib Qorri – gjendja me qentë endacak ne territorin e Komunës se Prishtinës nuk është e mire, kemi rritje te numrit edhe për kundër asaj qe jemi ne vazhdimësi duke u munduar ta trajtojmë këtë problem. Qe nga fillimi i mandatit kryetarit Rama problemin e pare qe e ka trajtuar për siguri është trajtimi i këtij problemi, fillimisht është krijuar një taskforce është kërkuar ndihme prej te gjitha organeve te cilët janë kompetent për këtë, ne mënyrë qe zgjidha e problemit me qentë endacak te mos jetë kërkosë vetëm ne territorin e Komunës se Prishtinës dhe gjithmonë presioni prej te gjitha aneve është tek Prishtina. Ne në vitin e kaluar pas shpalljes se gjendjes emergjente kemi lidhur kontrate emergjente për trajtimin e geneve endacak ku janë trajtuar 700 prej tyre, po ashtu kemi iniciuar projektin tjetër ne 7 llojtë tjera ne mënyrë qe te trajtohet çdo pjese e komunës se Prishtinës. Problemi është qe pas trajtimit jemi ti detyruar ti kthejmë aty ku i kemi marr dhe ata prap janë ne rruge ne parqe dhe ne raste te caktuara ka edhe sulme kafshime etj. Vitin e kaluar kemi filluar ndërtimin e qendrës për trajtimin e qenve endacak ne zonën e Hajvalise e cila është duke u finalizuar dhe shpresoj qe ne pjesën e pare te këtij vitiit ta funksionalizojme edhe qendrën. Strategjia dhe plani i veprimit për qentë endacak presim ditët ne vijim qe te kemi një ftese nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për te filluar sipas planit te veprimit i cili është hartuar ne bashkëpunim me organizata tjera kompetente. Javën e kaluar se bashku me z. Gecaj kemi qene prezent ne një raportim është bere një matje ne territorin e Prishtinës nga fondacioni për mbrojtjen dhe te drejtat e kafshëve, sipas matjeve te tyre ka dale se diku rreth 3000 qen janë ne territorin e Komunës se Prishtinës, është numër shume i madh kryesish neper zona ku gjejnë hapësirë vend për strehim dhe ushqim. Ne po ashtu kemi ndërtuar 24 pika ne pjese te qytetit te cilat i furnizojmë çdo dite me ushqim dhe ujë.

Pika e shtate te ndryshme

Hetem Kupina-ne mbledhjen e kaluar kam kërkuar qe ne te ardhmen ne pikën ne te ndryshme, te gjithë ata qe kane me adresuar ndonjë problem te adresohen ne këtë pike.

Ne një rruge Be Bardhosh me gjatësi diku 100-150 metra ka filluar një kompani me rregulluar rrugën qe 3 muaj dhe gjate punës i ka shkatërruar rrethojën e varrezave ortodokse, kane qene ne terren inspeksioni policia, ju lus qe te kontaktoni me kompaninë qe te filloj sa me shpejt me rregullimin e tyre. Po ashtu ne atë rruge kane hedhur rërë rruga është myllur dhe nuk kane nga te kalojnë qytetarët.

Melihate Sefedini- lidhur me dëmtimin e rrethojave te varrezave ortodokse jemi te njoftuar edhe ne, ne bashkëpunim me përfaqësuesin e komunitetit serb te fshatit Bardhosh nuk ka qene i interesuar te iniciojë procedure për dëmtim prone, janë te njoftuar inspeksioni e kemi thirr edhe përfaqësuesin e kompanisë "Kema", qe ka bere punimet aty dhe ne bashkëpunim me inspeksionin ka mbet qe kompania ne afat 5 ditësh me i kthyer rrethojat ne gjendjen e mëparshme.

Vjollca Hoti- desha te iu uroj për themelimin e drejtorisë se re Drejtoria për Siguri dhe Emergjencë. Kur jemi këtu desha te ngrit një ide te re qe se shpejti te realizohet një plan operativ menaxhim i incidentit kritik, kur kemi parasysh se çka po ndodhe ne Siri dhe ne Turqi, qe ti parandalojmë gabimet e ngjashme ne situata reale.

Proces Mbajtësja:

Edona Krasniqi

Kryetari i Kryeqytetit
Përparim Rama

